



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/1-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 11, paragrafi 1, pika e të Ligjit Nr. 08/L-122 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/1-122, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 18.01.2024, miraton këtë:

RREGULLORE E BRENDSHME NR. 06/2024

PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN PËR REGJISTRIM, CERTIFIKIM DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (ZRCKFSP)

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim që të përcaktojë organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ZRCKFSP.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë të punësuarit në ZRCKFSP.

Neni 3

Struktura organizative e ZRCKFSP

1. Struktura organizative e ZRCKFSP përbëhet nga struktura, si në vijim:

- 1.1. Zyra e Drejtorit;
- 1.2. njësitë.
2. Numri i të punësuarve në ZRCKFSP është dymbëdhjetë (12).
3. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore, është Shtojca 1 - Organogrami i ZRCKFSP.

Neni 4

Zyra e Drejtorit të ZRCKFSP

1. Struktura organizative e ZRCKFSP përbëhet nga struktura, si në vijim:
 - 1.1. Drejtori i ZRCKFSP;
 - 1.2. asistenti Ekzekutiv.
2. Në varësinë e Drejtorit të ZRCKFSP janë edhe pozitat e punës të cilat nuk janë pjesë e një njësie dhe të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret e ekzistimit si struktura organizative në ZRCKFSP. Pozitat në varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të ZRCKFSP, janë:
 - 2.1. Këshilltar juridik;
 - 2.2. specialist për administrimin e platformave elektronike;

Neni 5

Njësitë

1. Njësitë në ZRCKFS, janë:
 - 1.1. Njësia për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike;
 - 1.2. njësia për kontrollin financiar të subjekteve politike dhe inspektim.
2. Njësitë janë të barazvlefshme me divizionet.

Neni 6

Njësia për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike, janë:
 - 1.1. Jep udhëzime për personat ose grupet e interesuara për procedurën e regjistrimit të partisë politike;

- 1.2. shqyrton kërkesën për aplikim për regjistrim si parti politike të iniciativave politike, statutin e iniciativës politike, programin politik dhe përgatit rekomandimet në lidhje me procesin e regjistrimit të partisë politike;
- 1.3. pranon dhe verifikon të dhënat nga procesi i azhurnimeve vjetore të partive politike të regjistruara dhe nga procesi i vazhdimit vjetor të regjistrimit të partive politike;
- 1.4. monitoron kuvendet zgjedhore të partive politike dhe freskon listën e mbajtjes së kuvendeve zgjedhore të partive politike, sipas viteve;
- 1.5. jep udhëzime, kur dy ose më shumë parti politike paraqesin kërkesë për bashkim, për të formuar një parti të re dhe, kur një parti politike paraqet kërkesë që të shkrihet në një parti tjetër politike;
- 1.6. përgatit raportin me rekomandime për Drejtorin e ZRCKFSP, për çështjet që kanë të bëjnë me pezullimin e partisë politike dhe çregjistrimin e partisë politike;
- 1.7. rekomandon shqiptimin e gjobave, në rastet kur partitë politike dërgojnë me vonesë formularin e azhurnimit vjetor;
- 1.8. përditëson me kohë regjistrin e partive politike dhe siguron që regjistri i partive politike të publikohet në ueb faqen e KQZ;
- 1.9. harton planin me aktivitetet zgjedhore, që kanë të bëjnë me certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre dhe me akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve;
- 1.10. jep udhëzime për aplikim për certifikim në zgjedhje për partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur;
- 1.11. mban evidencë për partitë politike të regjistruara, që deklarojnë pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen në zgjedhje dhe pjesëmarrjen në zgjedhje përmes koalicionit;
- 1.12. harton procedurat për regjistrimin e partive politike, certifikimin e subjekteve politike për zgjedhje dhe akreditimin e vëzhguesve në zgjedhje;
- 1.13. pranon dhe shqyrton aplikacionet për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve në zgjedhje dhe mbikëqyr procesin e tërheqjes dhe zëvendësimit të kandidatëve për zgjedhje;
- 1.14. përgatit draft-shkresat për institucione, me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë/ aftësisë së kandidatit për certifikim në zgjedhje;
- 1.15. përgatit raportin me rekomandime për Drejtorin e ZRCKFSP, lidhur me certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve;

- 1.16. organizon dhe koordinon takimet me përfaqësuesit e autorizuar të subjekteve politike, si dhe organizon tërheqjen e shortit, që përcakton renditjen e subjekteve politike në fletëvotim;
 - 1.17. pranon dhe shqyrton aplikacionet për akreditim të vëzhguesve në zgjedhje dhe përgatit rekomandimet për Drejtorin e ZRCKFSP;
 - 1.18. kujdeset për mirëmenaxhim dhe ruan të dhënat konfidenciale të kandidatëve nga procesi i certifikimit dhe vëzhguesve nga procesi i akreditimit;
 - 1.19. me kërkesë të Drejtorit, për çështjet që bien në fushëveprimin e regjistrimit të partive politike dhe certifikimit të subjekteve politike, merr pjesë në organizimet brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.20. kryen detyra tjera që caktohen nga Drejtori i ZRCKFSP.
2. Udhëheqësi i Njesisë për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike, i raporton Drejtorit të ZRCKFSP.

Neni 7

Njësia për kontrollin financiar të subjekteve politike

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për kontrollin financiar të subjekteve politike, janë:
 - 1.1. Përgatit projekt-aktet nënligjore dhe udhëzimet për çështjet që kanë të bëjnë me financimin e subjekteve politike;
 - 1.2. harton dokumentin me termat e referencës për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e auditorëve të licencuar, për qëllime të auditimit të raporteve vjetore financiare dhe raporteve të deklarimit financiar të fushatës;
 - 1.3. mbikëqyr menaxhimin e kontratës për auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raporteve të deklarimit financiar të fushatës zgjedhore;
 - 1.4. kontakton me përfaqësuesit financiar të subjekteve politike para dhe gjatë procesit të auditimit, dhe i njofton subjektet politike për obligimet ligjore të përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - 1.5. në përputhje me dispozitat ligjore, bën verifikimin dhe trajtimin e të gjitha fakteve dhe gjetjeve të auditorit, me qëllim të vërtetimit të gjendjes reale dhe administron të gjitha faktet dhe sqarimet shtesë të ofruara nga subjektet politike, në funksion të nxjerrjes së vendimit meritot rreth raportimit në harmoni me ligjet në fuqi;

- 1.6. harton rekomandimet për shqiptimin e gjobave ndaj subjekteve politike, personave të saj përgjegjës, kandidatëve për kryetarë të komunave, kandidatëve të pavarur, personave fizik dhe juridik, në bazë të gjetjeve të auditorit;
 - 1.7. analizon raportet e auditimit dhe përgatit projekt-raportin për Drejtorin e ZRCKFSP, me qëllim që gjetjet të dërgohen në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe Administratën Tatimore të Kosovës, kur dyshimi për parregullsi bie nën kompetencën e institucioneve përkatëse;
 - 1.8. përgatit termat e referencës për shpalljen e tenderit për organizimin e trajnimit për përfaqësuesit financiar të subjekteve politike;
 - 1.9. udhëzon subjektet politike për zbatimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm financiar;
 - 1.10. koordinon punët për publikimin raporteve tremujore financiare, raporteve vjetore financiare dhe raporteve të deklarimit financiar të fushatës në ueb faqen e KQZ, para dhe pas auditimit dhe siguron që raportet financiare të publikohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 - 1.11. përgatit projekt dokumentin me të gjeturat e dala nga procesi i auditimit, që do të jetë pjesë e raportit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
 - 1.12. kryen mbikëqyrje në çdo rast, nëse konsiderohet se një subjekt politik ka shkelur dispozitat ligjore dhe kërkon dëshmi për verifikim, me qëllim të realizimit të mbikëqyrjes;
 - 1.13. monitoron fushatën e zgjedhjeve;
 - 1.14. me kërkesë të Drejtorit, për çështjet që bien në fushëveprimin e financimit të subjekteve politike, merr pjesë në organizimet brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.15. kryen detyra tjera që caktohen nga Drejtori i ZRCKFSP.
2. Udhëheqësi i Njësisë për kontrollin financiar të subjekteve politike dhe inspektim i raporton Drejtorit të ZRCKFSP.

Neni 8

Angazhimi i stafit në zgjedhje

ZRCKFSP, përmes konkursit të hapur publik, përzgjedh stafin e përkohshëm zgjedhor, në pajtim me Rregulloren (KQZ) nr. 02/ 2024 për Pranimin e personelit të Përkohshëm në KQZ.

Neni 9

Shërbimet e brendshme dhe mbështetëse

Kryesuesi i KQZ do të sigurojë që ZRCKFSP t'i ofrohen shërbimet administrative, logjistike, financiare, auditimit të brendshëm, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimet e ngjashme mbështetëse nga Sekretariati i KQZ, me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësisive të ZRCKFSP.

Neni 10

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Plotësimi i vendeve të lira punës bëhet brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore.
2. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit të rregullt dhe atij zgjedhor, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit, nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregullore, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.
3. Përshkrimi i detyrave të punës bëhet brenda periudhës një (1) mujore nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore, në pajtim me rregullat përkatëse për klasifikimin e vendeve të punës.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

Shtojca 1 – Organogrami i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike

Pozicioni/ struktura	Klasa	Grupi	Klasa	Numri
1. Zyra e Drejtorit të ZRCKFSP				
1.1. Drejtori i ZRCKFSP	Drejtues i lartë		X3	1
1.2. Asistenti Ekzekutiv	Profesional 2	Administrim i përgjithshëm	X7	1
1.3. Këshilltar juridik	Profesional 1	Specialist ligjor	X1	1
1.4. Ekspert i Bazës së të Dhënave	Profesional 1	Specialist i bazës së të dhënave	B6	1
Totali i të punësuarve në Zyren e Drejtorit				4
Pozicioni/ struktura	Klasa	Grupi	Klasa	Numri
2. Njësia për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike				
2.1. Udhëheqësi i Njesisë për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike	Drejtues i ulët		B7	1
2.2. Zyrtar i lartë për regjistrim dhe certifikim të subjekteve politike	Profesional 1	Specialist ligjor	B8	2
Totali i të punësuarve në Njësi				3
Pozicioni/ struktura	Klasa	Grupi	Klasa	Numri
3. Njësia për kontrollin financiar të subjekteve politike				
3.1. Udhëheqësi i Njesisë për kontrollin financiar të subjekteve politike	Drejtues i ulët		B7	1
3.2. Ekspert për kontroll financiar	Specialist 2	Specialist i auditimit	B8	4
Totali i të punësuarve në Njësi				5
TOTALI I TË PUNËSUARVE NË ZRCKFSP				12

